



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.151 dt.16.11.2001

**PER
MIRATIMIN E KALIMIT KAPITAL TE INVESTIMEVE TE VITIT 2000**

Mbështetur në Ligjin Nr.8652 dt.31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, Ligjit Nr.6942 dt.25.12.1984 “Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.153 dt.03.04.1993 “Për kalimin e objekteve të mjeteve kryesore të ndërmarrjeve dhe institucioneve buxhetore” pika 2/ç, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak

V E N D O S I

1. Të miratojë kalimin kapital të investimeve në vleftën prej **534.890.843** lekë, sipas pasqyrës bashkëlidhur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Ekonomike, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Njerëzore dhe Informacionit, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Infrastrukturës së Rëndë, Ndërmarrja Nr.1 e Punëtorëve të Qytetit, Ndërmarrja Nr.2 e Punëtorëve të Qytetit, Ndërmarrja Ujësjiellës-Kanalizime Sh.a, Muzeu, dhe Ndërmarrja e Funeralit
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETARI

Leonidha TOSKA

